



Instituti për Planifikim Hapësinor

Agjencioni për Mbrojtje e Mjedisit në Kosovë
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Raport

PUNËTORIA
"Trashëgimia kulturore e Pejës
– sfidat dhe mundësitë"

PROGRAMI
"Integrimi i trashëgimisë kulturore
në planifikim hapësinor dhe urban të nivelit qendror dhe lokal"

Partnerë:



Prishtinë
11.11.11



Fig. 1. Një foto e vjetër e qytetit të Pejës

Në kuadër të programit "Integrimi i trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor dhe urban të nivelit qendror dhe lokal në Kosovë" që po zhvillohet aktualisht nga Cultural Heritage without Borders (CHwB) dhe Instituti i Planifikimit Hapësinor (IPH), nga data 1 deri më 4 nëntor 2011, është mbajtur punëtorja "Trashëgimia kulturore e Pejës – sfidat dhe mundësitë". Përveç përfaqësuesve nga CHwB dhe IPH, në punëtori kanë marrë pjesë përfaqësues nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të komunës së Pejës, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim të komunës së Pejës, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Pejë, Muzeu Etnologjik Pejë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, UN Habitat dhe Intersos.



Fig. 2. Pjesëmarrësit e punëtorisë

Punëtorja ka qenë e strukturuar në dy module. Moduli i parë që është mbajtur më 1 dhe 2 nëntor në hotel "Solid" afër Therandës (Suharekës), ka qenë i përbërë nga seancat e punës në grupe punuese. Dhe moduli i dytë (3-4 nëntor 2011), është realizuar në Shqipëri përkatësisht në qytetet Shkodër, Lezhë dhe Krujë, duke u fokusuar në përmbajtjet e trashëgimisë kulturore.

Gjatë modulit të parë janë zhvilluar 7 seanca punuese, prej të cilave tri në ditën e parë dhe katër në ditën e dytë. Në seancën e parë, nga CHwB është bërë një prezantim për turizmin e bazuar në trashëgiminë kulturore dhe natyrore, me qëllim të njohjes së pjesëmarrësve për mundësitë reale në shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore për nevoja zhvillimore komunale. Ndërsa nga IPH është prezantuar çështja e nostalgjisë dhe ndikimi i sajë në zhvillimet e ardhshme në komunë, pas të cilës të gjithë pjesëmarrësit u inkuadruan në diskutim, i cili për epilog kishte vizatimin e hartës së nostalgjisë me përmbajtjet specifike për komunën e Pejës.



Fig.3. Foto e punës grupore

Gjatë seancës së dytë, pjesëmarrësit janë ndarë në tri grupe dhe secili grup e ka bërë SWOT analizën për trashëgiminë kulturore në territorin e komunës së Pejës. Seanca e tretë e punës ka qenë e dedikuar për prezantimin e SWOT analizës nga grupet. Në vazhdim, përkatësisht në seancën e katërt grupet punues duke pasur për bazë rezultatet e analizës së gjendjes momentale në fushën e TK, janë caktuar objektivat, aktivitetet dhe projektet konkrete që duhet të realizohen në favor të trajtimit të duhur të trashëgimisë kulturore në komunën e Pejës. Gjatë kësaj pune secili grup ka qenë i përqendruar vetëm në një temë e cila është caktuar paraprakisht dhe në kuadër të saj i ka identifikuar aktivitetet dhe projektet e nevojshme. Temat kanë qenë:

1. Mbrojtja dhe konservimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
2. Integrimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore në jetën bashkëkohore; dhe
3. Zhvillimi lokal – turizëm i bazuar në trashëgiminë kulturore dhe natyrore.

Puna e grupeve gjatë kësaj seance është prezantuar nga përfaqësuesit e grupeve gjatë të cilave janë zhvilluar debate të frytshme të cilat kanë ndikuar në ndryshimin e qëndrimeve përkatëse. Një vëmendje e posaçme i është kushtuar plotësisht dhe përmirësimit të listave me projekte e aktivitete të përpiluara nga grupet sipas rekomandimeve të dala nga diskutimet. Në seancën e fundit pjesëmarrësit kanë diskutuar për hapat dhe përgjegjësitë në vazhdim për përfundimin me sukses të punëtorisë sipas të cilave:

- deri në mes të muajit nëntor nga CHwB duhet të përfundojë raporti për punëtorinë e Pejës;
- në raport duhet të definojnë qartë aktivitetet dhe projektet të dakorduara nga të gjithë pjesëmarrësit;
- raporti i përfunduar do të prezantohet në komunën e Pejës në prani të Kryetarit dhe stafit komunal, nga të cilët do të kërkohej përkrahje në implementimin e rekomandimeve të dala në punëtori.

Moduli i dytë ka vazhduar në Shqipëri me arritjen e pjesëmarrësve në qytetin e Shkodrës. Vizita e parë është realizuar në kalanë "Rozafa" të Shkodrës dhe në muzeun historik që ndodhet në brendinë e kalasë. Ekspozitat e prezantuara në muze dhe shpjegimet e ciceronit, na ndihmuan që

përsëafërmi të njoftohemi me historinë e popullit të nënqiellit tonë nga koha antike-ilire deri në mesjetë.



Fig.4. Kalaja "Rozafa"



Fig.5. Muzeu historik në Shkodër

Më pas, pjesëmarrësit kanë vizituar muzeun historik të Shkodrës, i cili ka edhe karakter etnografik. Këtu vizitori, përveç që njoftohet me historinë dhe me gjërat që i ka përdorur populli i nënqiellit tonë që nga koha e ilirëve, ai ka mundësi të shohë edhe veshje kombëtare shqiptare të disa trevave dhe të shijojë arkitekturën karakteristike të shtëpive të pasura të Shkodrës të shekujve XVIII dhe XIX. Kjo edhe ka qenë vizita e fundit e planifikuar për këtë ditë, në kuadër të një agjendë shumë të ngjeshur. Qëndrimi dhe akomodimi është organizuar në një shtëpi muze (tash Hotel Tradita me emrin "Gegë e Toskë") e shpallur nën mbrojtje të shtetit dhe e mirëmbajtur në mënyrë të shkëlqyer nga pronari i tashëm.

Të nesërmen, u organizua një takim shumë me rëndësi në Drejtorinë e Kulturës për Rajonin e Shkodrës, në të cilën u zhvillua një bisedë shumë e frytshme me stafin menaxhues të kësaj drejtorie. Nga drejtoresha kuptuam se edhe në Shqipëri, çështja e trashëgimisë kulturore nuk është prioritet. Kohëve të fundit është duke ndodhur një tendencë pozitive për trajtimin e duhur të kësaj çështje. Strukturat vendimmarrëse të të gjitha niveleve janë më të vëmendshme dhe më rigorozë në respektimin e rregullave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Përmes fondeve qeveritare dhe disa fondeve ndërkombëtare, mund të shihet një përparim në këtë drejtim. Është ndryshuar pamja e zonave historike dhe momentalisht ato paraqesin atraksionin kryesor turistik për qytetin e Shkodrës. Indikator për këtë konstatim është numri përditë e më i madh i turistëve dhe përfitimet që kanë të gjithë sektorët zhvillimor.



Fig.6. Foto nga takimi në Drejtorinë e Kulruës të rajonit të Shkodrës

Më tutje, pjesëmarrësit vizituan fototekën "Marubi" në Shkodër, në të cilën janë të ekspozuara fotografitë e fotografit të famshëm shqiptar Kel Kodheli-Marubi, i cili me fotografimin e momenteve dhe personaliteteve më të rëndësishme të gjysmës së parë të shekullit XX, përmes fotografive të tij të mahnitshme e njofton vizitorin me një pjesë të historisë së popullit shqiptar. Kjo vizitë shënon fundin e vizitave në Shkodër.

Në vazhdim, u organizua një vizitë në qytetin e Lezhës, në të cilin pjesëmarrësit vizituan Mauzoleun e Skënderbeut, monumenti që shënon vendin ku ka qenë i varrosur hero i kombëtar i popullit shqiptar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Nga ciceroni u njoftuam me luftën, sakrificat dhe strategjinë e udhëhequr nga hero i kombëtar kundër pushtuesve osman. Fatkeqësisht në kuder të këtij objekti mund të shihen vetëm kopjet e e shpatës dhe përkrenarja e heroit të cilat në origjinal gjenden në muzeun e Vjenës.



Fig.7. Mauzoleu i Skënderbeut në Lezhë

Vizitat kanë vazhduar në qytetin e Krujës, ku fillimisht është vizituar pazari karakteristik i Krujës. Në dyqanet e pazarit me një arkitekturë karakteristike, vizitori gjen prodhime shumë të bukura artizanale, karakteristike për popullin shqiptar të prodhuara nga mjeshtrit popullor.



Fig.8. Pazar i vjetër në Krujë

Në Krujë ka pasuar vizita në muzeun kombëtar "Gjergj Kastrioti Skënderbeu". Në këtë muze, arkitektura e të cilit mjeshhtërisht i është përshtatur rrethit apo arkitekturës së kalave, pjesëmarrësit kanë mundur të shohin shumë gjëra, si kopje ashtu edhe origjinale që janë përdorur në kohën e Skënderbeut. Nga ciceroni dhe objektet e ekspozuara jemi njoftuar me të gjithë historinë e

zhvilluar gjatë kohës së Skënderbeut, jemi njoftua me bashkëluftëtarët dhe luftërat që janë zhvilluar nën udhëheqjen e heroit.



Fig.9. Muzeu historik i Skënderbeut në Krujë

Vizita e radhës u organizua në muzeun etnografik të Krujës, që prezanton një shtëpi të familjeve të pasura krutan nga fundi i shekullit XVIII, me një arkitekturë karakteristike dhe tipike për shtëpitë e të pasurve të asaj kohe. Kur hyn brenda, e ke ndjenjën e kthimit prapa në kohë, duke u njoftuar me mënyrën e jetesës së banorëve të shtëpisë në kohën kur ajo është shfrytëzuar. U njoftuam me funksionet themelore dhe karakteristike të shtëpive të pasura të asaj kohe, me enterierin e dhomave dhe gjërat që kanë përdorur familjarët, mjetet e punës dhe punët që i kanë kryer në këtë shtëpi. Njëra ndër momentet me rëndësi të veçantë për pjesëmarrësit, ishte këndi ku ishin të ekspozuara veshjet kombëtare shqiptare të disa trevave të Shqipërisë, një pjesë e të cilave janë përdorur edhe nga familja 35 anëtarësh e kësaj shtëpie.



Fig.10. Muzeu etnografik në Krujë

Vizita në muzeun etnografik të Krujës shënon fundin e vizitave dhe njehërit edhe të punëtorisë në përgjithësi. Rëndësia themelore e kësaj punëtorie ishte puna në grup të përzier, me përfaqësues të niveleve dhe institucioneve të ndryshme, të cilët debatuan dhe nxorën rekomandime të rëndësishme për trajtimin e duhur të trashëgimisë kulturore. Një aktivitet i tillë u pasua me vizitën që u bë në disa qytete të Shqipërisë, që sipas pjesëmarrësve ishte me shumë ndikim, dhe ndërlidhje direkte e aktiviteteve me praktikën e zhvilluara në Shqipëri.

Me respekt,

Luani, Arbni, Festa dhe Shpendi
Instituti për Planifikim Hapësinor